



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1386/24 Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - *Gjuhë Angleze – Përkthim dhe interpretim BA 180 ECTS me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.*
- II.** Akreditohet programi i studimit i Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Gjuhë Shqipe MA 120 ECTS me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.*
- III.** Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Shëndeti Publik BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik,*
 - *Menaxhimi shëndetësor MA 120 ECTS me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik.*
- IV.** Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- V.** Obligohet Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI.** Obligohet Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- VII.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VIII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Gjuhë Angleze -Përkthim dhe interpretim BA 180 ECTS (R)</i>	Elsa Vula Mejreme Ymeri Nazli Tyfekqi
2.	<i>Gjuhë Shqipe MA 120 ECTS (A)</i>	Fridrik Dulaj Petrit Duraj
3.	<i>Shëndeti Publik BSc 180 ECTS (R)</i>	Antigona Ukëhaxhaj Haxhi Kamberi Hajrullah Latifi
4.	<i>Menaxhimi shëndetësor MA 120 ECTS (R)</i>	Faton Hoxha Artan Nimani

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Gjuhë Angleze – Përkthim dhe interpretim BA 180** më 22.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Beatriz López dhe Matej Drobnic, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4) ndërsa Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit..
- Për programin e studimit; Gjuhë Shqipe MA 120**, më 22.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Dhurata Shehri dhe Matej Drobnic, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) ndërsa Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit..
- Për programin e studimit; Shëndeti Publik BSc 180 ECTS** më 22.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Joke Denekens dhe Nibal Sabri, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit..
- Për programin e studimit; Gjuhë Shqipe MA 120**, më 22.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Ketevani Kankava dhe Nibal Sabri, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) ndërsa Substancialisht katër (4) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit..

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

